

WHAT MAKES A GOOD TEACHER

Teuta Iljazi

University of Tetovo, Tetovo, Republic of Macedonia, teuta.iljazi@unite.edu.mk

Abstract: The teacher is the person who teaches children in elementary school. The teachers have different roles and they are more than transmitters of information and skills to learners. A good teacher is more than just an educator. What are the characteristics of a good teacher? In this study are set out some criteria in the questionnaire that was completed by the students of the Faculty of Education and the teachers of some elementary schools of Tetova. Data were collected from 71 students and 74 elementary school teachers by means of a questionnaire that included open-ended questions which were analyzed qualitatively. In this study students of 3rd and 4th year of the Faculty of Education from Tetova University and elementary school teachers answered the questions “what makes a good teacher”. This study found that there are differences between students’ and teachers’ beliefs. From students’ view more important is the lecture to be attractive and interesting, but from teachers view more important is to be promoter for all students.

Keywords: teacher, teaching, teaching methods, teacher role.

ÇFARË E BËN NJË MËSUES TË MIRË

Teuta Iljazi

Universiteti i Tetovës, teuta.iljazi@unite.edu.mk

Abstrakti: Mësuesi është personi, i cili i mëson fëmijët në shkollën fillore. Mësuesit kanë role të ndryshme dhe ato janë më shumë se transmetuesit e informacionit dhe shkathtësive për nxënësit. Një mësues i mirë është më shumë se vetëm një edukator. Cilat janë karakteristikat e një mësuesi të mirë? Në këtë studim u parashtrua disa kriterë në pyetësinë e plotësuar nga studentët e Fakultetit të Edukimit dhe mësuesit e disa shkollave fillore të Tetovës. Ky studim do të nxjerr si përfundim cilat janë karakteristikat e një mësuesi të mirë nga këndvështrimi i studentëve dhe mësimeve të tyre. Të dhënat u grumbulluan nga 71 studentë dhe 74 mësues të shkollave fillore me anë të një pyetësi që përfshinte pyetje të hapura të cilat u analizuan në mënyrë kualitative. Në këtë studim, studentët e vitit të tretë dhe të katërt të Fakultetit të Edukimit nga Universiteti i Tetovës dhe mësuesit e shkollave fillore u përgjigjën pyetjeve “çfarë e bën një mësues të mirë”. Ky studim shpreh se ekzistojnë dallime në mes qëndrimeve të studentëve dhe të mësuesve. Sipas studentëve më e rëndësishme është që leksioni të jetë tërheqës dhe interesant, por nga pikëpamja e mësuesve është më e rëndësishme mësuesi të jetë nxitës dhe stimulues për të gjithë nxënësit.

Fjalët kyçe: mësuesi, mësime, metoda të mësimit, roli i mësuesit.

1. HYRJA

Të jeshë mësues në shkollë fillore do të thotë ta keshë të kryer shkollimin e lartë në ndonjërin nga universitetet, fakultetin pedagogjik-drejtimi klasor, i cili emërtim njihet si fakulteti i edukimit që pregadit quadro për të edukuar fëmijë të moshës parafillore dhe fillore. Përcaktimi i vetive për të qenë një mësues i mirë është mjaft vështirë sepse pikëpamjet ndryshojnë mvarësisht nga këndvështrimi i përcaktuesit ose vrojtuesit. Hulumtues të ndryshëm mësuesin e mirë e kanë emërtuar edhe si “mësuesi ideal” (Aksoy,1998;Arnon &Reichel,2007). Hulumtuesit dhe mësimeve të tyre kanë shpenzuar shumë kohë për të shqyrtuar mësuesin në aspektin e personalitetit, tiparet e tij, sjelljet, qëndrimet, aftësitë, kompetencat, efektivitetin, stilet e mësimit, marrëdhëniet me prindërit dhe nxënësit si dhe shumë karakteristika të tjera për të përcaktuar çfarë e bën një mësues të mirë. Studiues, bashkëpunëtorë, prindër, administratorë dhe mbikëqyrësit kanë krijuar lista me këto karakteristika të mësimeve të tyre. Kur secili prej tyre grupeve vlerësojnë mësuesit, përdorin instrumente të ndryshme, duke përfshirë listat e kontrollit, testet e personalitetit, shkallët e qëndrimit ose instrumentet e vëzhgimit. Kërkuesit gjithashtu kanë studiuar perceptimet e nxënësve të karakteristikave efektive të mësuesit dhe mësuesin efektiv. Në kohën e ndryshimeve të mëdha në planin global dhe atë lokal, vendi i mësuesit në shoqëri e ka humbur vendin e merituar në shoqëri. Për këtë, indikatorë janë mosigurimi i kushteve për mbarrëvajtje të mirë të procesit edukativo arsimor, pagat e ulta të mësuesve, investimi jo i mjaftueshëm në aftësim të mësuesve, mospërfshirja e mësuesve në përpilimin e teksteve mësimore, mospërfshirja e mësuesve në reformat arsimore etj.

Sipas P.Miller (1987) në studimin “Ten characteristics of a good teacher” cilësitë e një mësuesi të mirë janë të ndara në katër fusha: 1.fusha afektive, 2.fusha e shkathtësive, 3. teknika të menaxhimit të klasës dhe 4. njohuritë

akademike. Në fushën afektive janë të përfshira karakteristikat si entuziazmi, inkurajimi, humori, interesimi për studentët, kurse sferën e shkathtësive janë të përfshira kreativiteti dhe sfida. Në sferën e menaxhimit të klasës si karakteristikat që duhet të posedojë mësuesi për të qenë i mirë janë përfshirë vetita e objektiviteti si dhe shpejtësia e të vepruarit. Gjithashtu sipas të njëjtit burim karakteristikat e mësuesit nga fusha afektive mvaret nga aftësia e tij për ti demonstruar ato. Duhet të ceket që disa nga vetitë të cilat shprehen dhe demonstohen mvaren edhe nga vetë materiali ose edhe mjetet të cilat janë në disponim të mësuesit. Mësuesi, i cili është ekspert në profesionin e tij ai është në gjendje që ti çelë sytë e nxënësve të vetë. Studimet në lidhje me karakteristikat e mësuesit të mirë janë bërë në vende të ndryshme dhe nga pikëpamje të ndryshme. Kjo përmendet edhe tek M.Bullock (2015) që përmend disa studime të mendimeve të mësuesve në lidhje me karakteristikat e mësuesit të mirë (Beijaard, Verloop & Vermunt, 2000; Sahin & Cokadar, 2009), mendimet e studentëve për vetitë e mësuesit të mirë (Cook-Slather, 2002; Gurung & Vespia, 2004), mendimet e nxënësve (Aksoy, 1998; Beishuizen et al., 2001). Studime të ngjajshme janë kryer edhe në Kanada (Vander Kloet & Chugh, 2012; Ciascai & Vlad, 2014), në Turqi (Sahin & Cokadar, 2009), në SHBA (Cook-Slather, 2002; Arnon, 2007), etj. Ky studim bazohet në studimin e mendimeve ose bindjeve të mësuesve të shkollave fillore në lidhje me vetitë e një mësuesi të mirë, si dhe mendimet e studentëve të cilët në të ardhmen e afërt vetë do të bëhen mësues. Të jeshë mësues dhe të bëhesh i mirë-ideal do të thotë të jeshë artist i mirë, prind i mirë dhe ekspert i profesionit. Duhet të thuhet në vende të ndryshme, kultura të ndryshme mësuesi i mirë identifikohet në mënyra të ndryshme, Si p.sh në Izrael mësuesi i mirë është krijues i kombit me përgjegjësi të transmetimit të njohurive- dijes kulturore gjeneratës së re. Nga ana tjetër në Norvegji mësuesi trajtohet si kujdestar dhe përkthyes i tekstit. Në Angli mësuesi i mirë është personi me super kualitet, që ka njohuri dhe shkathtësi pedagogjike si dhe mbizotëron materialin e lëndës që e shtjellon. SHBA mësuesin e mirë e konsiderojnë si artist të mirëfillt me njohuri solide dhe imagjinatë të zhvilluar. Mendimet e një shoqërie vijnë nga mendimet e pjesëtarëve të asaj shoqërie, të cilat edhe hulumtohen. Pjesë e një shoqërie janë edhe studentët, mendimet e të cilëve i hasim në studime të ndryshme. Sipas Aksoy (1998), studentët e Tuqisë janë të mendimit se mësuesi i mirë është ai i cili ka raporte të mira në relacion me nxënësit. Mendimet e nxënësve të Holandës është se mësuesi i mirë është instruktor kompetent dhe nuk ka të bëjë me aspektin e raporteve me nxënësit (Beishuizen et al., 2001). Studimi i White, (2009) në Austri sipas Bullock (2015) shpreh se nxënësit mësuesin e mirë e përcaktojnë me përkushtimin e tij në spjegimin e përmbajtjeve mësimore, ndërsa në bazë edhe të studimeve të tjera studentët janë të mendimit se mësuesi i mirë është ai, i cili është edhe menaxhues i mirë i klasës dhe dëgjues i mirë i përgjigjeve të nxënësve. Duhet të ceket që nxënësit e moshave të ndryshme në mënyra të ndryshme e identifikojnë mësuesin e mirë. Mendimet e nxënësve në lidhje me identifikimin e mësuesit të mirë është subjektive, që do të thotë se edhe nxënësit kanë përvoja të ndryshme, përjetime të ndryshme dhe kanë sfond personal të ndryshëm. Mendimet e studentëve të mi në këtë studim janë mbledhur nga përvoja e tyre si nxënës, nga aftësimi si student të fakultetit të edukimit si dhe nga praktika pedagogjike në lëndën e matematikës e realizuar nëpër disa shkollat fillore. Gjatë praktikës pedagogjike studentët janë aftësuar të përcjellin mësuesit që realizojnë orën nga lënda e matematikës duke ndjekur metodat e punës, format e punës, mjetet mësimore, teknikat e mësimdhënies, duke mos anashkalluar sjelljen e mësuesve me nxënësit si dhe kompetencat në lidhje me përmbajtjen mësimore nga matematika. Është me rëndësi të ceket aftësia menaxheriale e mësuesve në klasë si dhe aftësia e tyre për ti kyçur të gjithë nxënësit në aktivitetet mësimore duke mos i përjashtuar edhe nxënësit me nevojë të veçanta. Kur flitet për mësuesin efektiv duhet të ceket se mësuesi i mirë është ai i cili është nxënës i përgjeshëm që do të thotë ai i ndjek të rejtat në mësimdhënie, të rejtat pedagogjike në mësimdhënie si dhe të rejtat në të nxënësit. Krijimi i mjedisit tërheqës, aktiv dhe kreativ ku kyçen të gjithë nxënësit e bën mësuesi, i cili ka njohuri përveç të lëndës, por i cili ka njohuri të përgjithshme dhe të veçanta pedagogjike. Nuk duhet përjashtuar edhe aspektin psikologjik, sepse nxënësit janë burim heterogjen në aspektin kognitiv, emocional dhe motivues. Disa studime sipas Guerriero. S profesionin e mësuesit e krahasojnë me profesionet praktike klinike. Ky krahasim është në bazë të vendimarrjes që e bën mësuesi në orën mësimore gjatë të cilit ai dëshiron të rrisë të kuptuarit e nxënësve në klasë. Që do të thotë procesi i mësimdhënies së suksesshme është i lidhur ngushtë me procesin e të nxënësit. Sepse një mësimdhënie e suksesshme siguron të nxënësit të suksesshëm. Gjithashtu ekzistojnë studime të cilët bëjnë me dije që vendimarrja e mësuesit mvaret nga nxënësit, njësia mësimore, kushtet shkollore të cilat kombinohen me karakteristikat e vetë mësuesit, i cili do të marrë vendimin përkatës.

2.METODOLOGJI E HULUMTIMIT

Ky studim bazohet në të dhënat e mbledhura nga pyetësi që është plotësuar nga 71 studentë të fakultetit të edukimit të drejtimit klasor –viti i III dhe studentët e vitit të IV. Po të njëjtin pyetësor e kanë plotësuar edhe 74 mësues të ciklit të ulët të disa shkollave nëntëvjeçare të Tetovës. Pyetësi është formuluar me përdorim të shkallës së Likertit me shkallëzim 1-5 që është i besueshëm meqë vlera e koeficientit Conbach Alpha 0.834.

Me anë të këtij pyetësori janë marrë mendimet e studentëve dhe të mësuesve në lidhje me atë se cilat karakteristika duhet ti posedojë një mësues i mire. Në profesionin mësues dita ditës mbizotëron gjinia femërore, këtë e tregon edhe pyetësori ku sipas të cilit janë anketuar 66 mësuese dhe vetëm 8 mësues, që do të thotë afërsisht 90% e të mësuesve të anketuar janë të gjinisë femërore. Duke kërkuar që të mbledhë të dhëna në lidhje me përvojën e punës së mësuesve, ata i kam kategorizuar në 5 grupe: 10% prej tyre janë me përvojë pune më pak se 5 vjet, 22% janë me përvojë pune prej 5vjet gjer 10 vjetë. Me po atë numër janë të përfaqësuar mësuesit me përvojë pune prej 10 vite gjer 15 vite. Mësuesit e anketuar që kanë përvojë pune prej 15 vite gjer 20 vjetë janë gjithësejt 15% nga numri i përgjithshëm, ndërsa pjesa tjetër janë me përvojë pune mbi 20 vjet.

Pyetësorin e kam realizuar edhe me 71 studentë, prej të cilëve 66 janë të gjinisë femërore dhe vetëm 5 të gjinisë mashkullore. Nga numri i përgjithshëm 38 janë të vitit të III, ndërsa 33 janë të vitit të IV. Suksesi i studentëve të anketuar është paraqitur në Tabelën 1 që është paraqitur më poshtë:

Tab.1. Suksesi i përgjithshëm i studentëve

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja valid	Përqindj kumul
Valid	6-7	13	18.3	18.3	18.3
	7-8	34	47.9	47.9	66.2
	8-9	19	26.8	26.8	93.0
	9-10	5	7.0	7.0	100.0
	Total	71	100.0	100.0	

Nga tabela shihet që suksesi mesatar që mbizotëron tek studentët e anketuar është suksesi ndërmjet 7-8 me një përqindje prej afër 48%. Meqë një ndër lëndët e rëndësishme në shkollimin e nxënësve është edhe lënda e matematikës, që kërkon një pregaditje të mirëfillt të mësuesve; një ndër pyetjet e pyetësorit ka qenë edhe suksesi në lëndën e matematikës së studentëve të anketuar. Këto të dhëna janë paraqitur në Tab.2 të dhënë si më poshtë:

Tab.2. Suksesi i studentëve në lëndën e matematikës

		Frekuenca	Përqindja	Përqindj valide	Përqindj kumul
Valid	5	20	28.2	28.2	28.2
	6	22	31.0	31.0	59.2
	7	16	22.5	22.5	81.7
	8	4	5.6	5.6	87.3
	9	7	8.5	8.5	95.8
	10	2	2.8	2.8	100
	Total	71	100.0	100.0	

Nga tabela shihet që numri më i madhë i studentëve është me sukses 6 dhe 7 në lëndën e matematikës. Nuk është i vogël as numri i studentëve me njohuri të pamjaftueshme nga lënda e matematikës që është 28%. Rritja e suksesit në lëndën e matematikës do të ndikonte në rritjen e suksesit të përgjithshëm të studentëve. Duhet të ceket se poqese studentët janë me një bazë më të mirë nga shkollimi paraprak, atëherë edhe suksesi gjatë studimeve do të ishte më i lartë, gjë që do të siguronte mësues më të pregaditur për kryerjen e këtij profesioni.

Pas përpunimit të pyetësorit të plotësuar nga mësuesit dhe studentët janë fituar vlerat mesatare për secilën pyetje që shpreh një karakteristikë për mësuesin. Vlerat mesatare nga të dy pyetësorët janë paraqitur sëbashku në Tabelën 3 prej ku mund ti krahasojmë mendimet e mësuesve dhe mendimet e studentëve në lidhje me karakteristikat e mësuesit që e bëjnë atë të mirë. Nga tabela vërejmë që mesataret e fituara nga pyetësori i mësuesve janë më të larta që do të thotë se mësuesit kanë mendimin se plotësisht pajtohen që karakteristikën në fjalë duhet ta posedojë një mësues që të jetë i mirë. Sipas mësuesve që të jeshë një mësues i mirë duhet ta keshë notën mesatare 4.802546, ndërsa sipas studentëve mësuesi i mirë duhet të ketë notë mesatare 4.480422. Nga të dhënat të paraqitura në Tab.3 shihet që ndryshimi më i madhë në mendimet ndërmjet mësuesve dhe studentëve është tek aftësia e përdorimit të TIK në mësimdhënie nga ana e mësuesve. Ky ndryshim i mesatareve është 0.6938. Mendimet më të përafërta ndërmjet mësuesve dhe studentëve është tek vetia që mësuesi duhet të jetë ekspert me një ndryshim prej 0.0847,

mësuesi i mirë duhet ta bëjë orën tërheqëse me një ndryshim prej 0.1443, mësuesi i mirë respekton me një ndryshim prej 0.1589.

Tab.3 Karakteristikat e mësuesit të mirë

Mësuesit				Studentët			
Karakteristika	Vlera mesatare	N	Std.Deviation	Vlera mesatare	N	Std	Ndryshimi
Durueshëm	4.8108	74	.42766	4.4507	71	.77069	0.3601
Fleksibil	4.7027	74	.54219	4.3380	71	.79181	0.3647
Kreativ	4.9054	74	.33796	4.6197	71	.72440	0.2857
Ekspert	4.6622	74	.57996	4.5775	71	.68997	0.0847
Punë ekipore	4.8378	74	.43877	4.5493	71	.73268	0.2885
Punë me prindërit	4.8378	74	0.37112	4.4366	71	.93705	0.4012
Bashkëpunues	4.784	74	.4760	4.6056	71	.70668	0.1784
Nx kontinual	4.5135	74	.52975	3.9859	71	.87002	0.5276
Principiel	4.5541	74	.62245	4.1831	71	.88334	0.371
TIK	4.5811	74	.64121	3.8873	71	1.14079	0.6938
I kujdesshëm	4.91892	74	0.274823	4.5915	71	.68822	0.32742
Respekton	4.9054	74	.33796	4.7465	71	.57863	0.1589
I organizuar	4.8919	74	.31264	4.5493	71	.62767	0.3426
Pozitiv	4.824	74	.4490	4.6197	71	.74385	0.2043
Ora tërheqëse	4.9189	74	.32082	4.7746	71	.59033	0.1443
Vleresues i mirë	4.919	74	.2748	4.5915	71	.76676	0.3275
Inkurajues	4.9324	74	.2572	4.5352	71	.67254	0.3972
Stimulonnjëlloj	4.9459	74	.22767	4.6056	71	.93318	0.3403
Mesatarja	4.802546			4.480422			0.322123

3.PËRFUNDIME

Ky studim, i cili ka përfshirë mësues me përvojë të ndryshme dhe student që pas disa vitesh do ta ushtrojnë profesionin e mësuesit sjellë përfundime se mësuesit kanë kriteriumet më të larta në përcaktimin e vetive të mësuesit të mirë, që do të thotë se puna me nxënës, përvoja e punës, kontaktet me prindërit e nxënësve, shkolla si mjedis, mjetet mësimore, materialet dhe përmbajtjet mësimore ndikojnë në mendimet dhe qëndrimet e mësuesve, ndërsa studentët, të cilët ende nuk janë të ballafaquar me këto gjëra i kanë kërkesat dhe kriteriumet në nivel më të ulët. Studentët në përcaktimin e mendimit të tyre janë të ndikuar edhe nga pozita e vëzhguesit ose nxënësit dhe nuk janë të vëtedijshëm për përgjegjësinë e një mësuesi. Suksesi mesatar i përgjithshëm, 50% prej studentëve të cilët e kanë plotësuar pyetësorin kanë suksesin ndërmjet 7-8, ndërsa është i pakët numri i studentëve me sukses më të lartë., që do të thotë se studentët që e regjistrojnë këtë drejtim janë me sukses të pamjaftueshëm për të qenë të suksesshëm. Sa i takon suksesit mesatar nga lënda e matematikës që është shumë i ulët afërsisht 6.5, paraqet një tregues për

mësuesit e ardhshëm, të cilët duhet të angazhohen më shumë në aftësimin dhe shëndrimin e vehtes në ekspert. Për të qenë mësues i mirë nuk mund të caktohen kufijtë e kërkesave dhe karakteristikave. Kërkesat dhe karakteristikat janë nga më të ndryshmet dhe janë nga pikëpamje të ndryshme.

4.PROPOZIME

Nga ky studim, nga përfundimet e nxjerra prej tij dhe nga përvoja e punës me studentët e fakultetit të edukimit mund të formulohen disa propozime që të arrihet në krijimin e kuadrove të mira në shkollimin fillor. Ndër këto është të stimulohen nxënësit e mirë nga shkollat e mesme të regjistrohesh në Fakultetin e Edukimit. Gjithashtu nxënësit të cilët regjistrohen nga shkollat e mesme profesionale ku matematika është më pak e përfaqësuar ti nënështrohen provimit pranues të matematikës ose të organizojë fakulteti kurs pregaditor nga lënda e matematikës. Lënda e matematikës në fakultetin e edukimit të jetë e përfaqësuar me më shumë orë, me qëllim të pregaditjes adekuate të studentëve të cilët vijnë nga shkolla të mesme të ndryshme dhe nga vende të ndryshme. Institucionet përgjegjëse për aftësimin e mësuesve këtë ta bëjnë në mënyrë kontinuale që mësuesit e mësimit klasor të aftësohen në lëndën e matematikës me metodat, teknikat dhe mjetet e reja. Në kuadër të librit shkollor të përpilohet edhe libri i mësuesit nga lënda e matematikës, i cili do të ndihmonte mësuesit gjatë procesit mësues si udhëzues për të qenë më i suksesshëm për orën e matematikës.

BIBLIOGRAFIA

- [1] Aksoy.N, (1998) "Opinions of upper level elementary students about a "GOOD TEACHER"ERIC.
- [2] Armstrong P ,(2015) Teacher characteristics and student performance: An analysis using hierarchical linear modelling, South African Journal of Childhood Education
- [3] Bullock,B (2015) What Makes a Good Teacher? Exploring Student and Teacher Beliefs on Good Teaching, Rising Tide Volume 7
- [4] Guerriero.S. . "Teacher's Pedagogical knowledge and the teaching profession"OECD
- [5] Kosgei1,A, Kirwa ,J(2013) "Influence of teacher characteristics on students' academic achievement among secondary schools" Journal of Education and Practice, Vol.4, No.3, 2013,
- [6] Esmaeilian,M; Rahmani T. (2014) "Comparison of characteristics of teachers in primary schools, with idealism teachers features" Technical Journal of Engineering and Applied Sciences,
- [7] Miller,P (2012)"Ten Characteristics of a Good Teacher" English teaching Forum.Vol.1